

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Shtimes z. Naim Ismajli**

I nderuari z. Ismajli,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shprehur që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Implementimin e 108 projekteve kapitale në 4 vitet e ardhshme në vlerë prej 45 milion eurosh;
- Zhvillim ekonomik dhe përkrahje në bujqësi, veçanërisht mbështetje të fermerëve përmes subvencionimit nga komuna dhe qeveria;
- fermerëve;
- Zhvillim rural dhe turizëm;
- Shërbime më të mira komunale;
- Përkrahje për arsimin, kulturën, rininë dhe sportin;
- Shëndetësi dhe mirëqenie sociale më të mirë;
- Ambient më të pastër;
- Ndërtimin e një minihidrocentrali prej 600Mw;
- Për fshatin Belincë: ndërtimin e rrugës dhe të kanalizimit, si dhe ndërtimin e shkollës së re;
- Për fshatin Zborc : ujësjellësin, asfaltimin e rrugëve të mbetura dhe një fushë sportive;
- Për fshatin Reçak: asfaltimin e çdo rrugice dhe vendosjen e kanalizimit;
- Për fshatin Petrovë: ndërtimin e shkollës së re me sallë të edukatës fizike, ndërtimin e urës së re, trotuarin përgjatë rrugës kryesore, një terren sportive, rregullimin e kanalizimit, ndërtimin e administratës për shërbime administrative dhe ujësjellësin i cili do të ketë edhe një burim alternative në Grykë të Topillës;
- Për fshatin Vojnovcë: kanalizimin, asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave , rregullimin e shtratit të lumit si dhe ndërtimin e një shkolle;
- Për fshatin Muzeqinë: ndërtimin e një rezervuari për furnizim me ujë të pijshëm, ndërtimin e një shkolle të re, asfaltimin e rrugicave, rregullimin e kanalizimit dhe një zyre administrative;
- Për fshatin Gjurkocv: ndërtimin e një objekti të ri shkollor dhe kanalizimin e fshatit;
- Për fshatin Godanc: kanalizimin dhe rrugë të asfaltuara në çdo lagje ku do të kaloj autoudha, e cila do të jetë nyje lidhëse për te;
- Për fshatin Mollopolc: asfaltimin e të gjitha rrugëve të fshatit, shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimin për ujërat e zeza, rregullimin e një terreni sportiv, subvencionim të fermerëve;
- Përfundimin e Kompleksit Përkujtimor të Recakut;
- Pastrimin dhe zgjerimin e lumit nga Carraleva deri në Mollopolc;

- Kanalizimi i fshatit në Davidovc;
- Avancimin e femrës në punësim dhe shkollim;
- Mbështetjen e studentëve me bursa, dhe hapjen e vendeve të reja të punës;
- Ndërtimin e rrugës unazë, e cila tashmë një segment e ka të përfunduar;
- Në vitin 2010 Shtimja do ta ketë çerdhen publike (është aprovuar buxheti për ndërtimin e çerdhes, dhe personelin). Kapacitetet e para do të jenë nga 70-100 fëmijë. Vjeshta e vitit 2010 pritet të filloj me çerdhe;
- Ndërtimin e shtëpisë së zjarrfikësve, e cila do të ketë dy automjete;
- Ngritjen e Stacionit të autobusëve në partneritet publiko-privat, në vitin 2011;
- Përfundimin e palestrës së sportit në tetor 2010, dhe 3 fusha të tjera sportive (Shtime, Godanc, Davidovc) në vlerë prej 2, 220 milion euro,
- Ndërtimin e Qendrës Kulturore Multipleks, e cila do të jetë me shërbime të integruara për kulturën dhe për rininë (zyra të kulturës, salla për teatro, biblioteka, qendra tregtare etj.), projekt i cili do të përfundoj brenda mandatit 4 vjeçar – me partneritet publiko-privat;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)